



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 114/12 Prot.

Berat, më 05.01.2022

VENDIM

Nr. 4, datë 05.01.2022

PËR

**PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. LEKS TRIFON GJIKA**

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 5 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit nr. 429, datë 12.09.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar me Vendimin nr. 730, datë 02.09.2015 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, Këshilli në Qarkun Berat pas shqyrtimit në datë 05.01.2022, të kërkesës së Z. Leks Trifon Gjika dhe dokumentacionit shoqërues, për përfitim Shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror,

VENDOSI:

1. T'i propozohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e Shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror Z. Leks Trifon Gjika, “Për Shërbime të Shquara Shtetërore dhe Shoqërore”.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës për Shqyrtimin e Kërkesave për Pension/Shtesë pensioni të Posaçëm Shtetëror në Këshillin e Qarkut Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Këshilltar gjithsej: 18

Morrën pjesë në votim: 10

Votuan Pro: 10

